

1. Si dhe kur mund të prezantohet kërkesa për regjistrim?

Për vitin shkollor 2017/2018 kërkesa për regjistrim në kopshtet komunale mund të prezantohet nga **16 janari 2017 deri më 6 shkurt 2017**, ekskluzivisht *on line*:

-duke u lidhur direkt nga kompjuteri juaj në Shërbimet On Line të Komunës së Firences: <https://servizi.055055.it/iscrizionimaternefe/>

Vetëm në rast pamundësie për të bërë regjistrimin online nga kompjuteri juaj, do të jetë në dispozicion personeli i Drejtorisë arsimore, në rrugën Nicolodi n. 2, në katin e dytë, zyrat 56 në ditët; e hënë, e mërkurë dhe e premte nga ora 9 deri më 12,30.

Në këtë rast **është i nevojshëm që të prenotohet një takim** duke telefonuar në oraret 9-12,30 në numrat 055 2625748/0552625749. Regjistrimi do të kryhet **vetëm me kredencialet e identifikimit të njërit prej prindërve/tutorëve.**

Qytetarët e huaj mund të paraqiten në **Zyrën e Emigracionit** Lagjia 5 – Villa Pallini, Rruga Baracca 150 p, ku ndërmjetësit gjuhësor - kulturorë do t'ju ofrojnë ndihmën e nevojshme për plotësimin e formularit on-line.

http://politichesocioabitative.comune.fi.it/stranieri/servizi/sportelli_immigrazione.html

2. Çfarë nevojitet për të hyrë në shërbimin On-Line për plotësimin e kërkesës?

Për të bërë regjistrimin duhet që të keni një nga dokumentat e mëposhtëm:

1. Kredencialet e identifikimit (fjalëkalimi dhe password) kush nuk i ka mund t'i kërkojë pranë zyrave të Marrëdhënieve me Publikun (URP) të Komunës së Firences, zyrave të Shërbimit për kopshtet, rruga Nicolodi n. 2 ose, nëse je qytetar i huaj pranë zyrës së Emigracionit, Rruga Baracca 150p, kredencialet mund të lëshohen dhe pranë sportelit të PAD (zyra të decentralizuara të gjëndjes civile) te Parterre çdo ditë (përveç të shtunave ku duhet marrë një takim nëpërmjet 055055); pranë PAD-ve të tjerë në ditët e hapjes për publikun siç tregohet në linkun e mëposhtëm;

http://politichesocioabitative.comune.fi.it/stranieri/servizi/sportelli_immigrazione.html

2. Karta shëndetësore e qarkut të aktivizuar në zyrat e ASL-it të Qarkut të Toskanës (për informacione www.regione.toscana.it/servizi-online/servizi-sicuri/carta-sanitaria-elettronica)*

3. Karta kombëtare të Shërbimeve (CNS) *

<http://www.regione.toscana.it/-/carta-nazionale-dei-servizi>

* Për ata që dëshirojnë të futen në shërbimin On-Line VETËM nga PC-a personal, dhe kanë Kartën shëndetësore të qarkut dhe Kartën kombëtare të shërbimeve të aktivizuar është i domosdoshëm lexuesi smart card, i cili mund të blihet pranë Zyrave Shëndetësore.

Ju kujtojmë se regjistrimi me kredencialet tuaja e bërë një herë, është i vlefshëm jo vetëm për shërbimet e shkollave por për të gjitha shërbimet e komunës on line, si për shembull, për çertifikata të gjëndjes civile të stampuara nga PC-ja personal.

4. SPID Sistema Pubblico per l'Identità Digitale

<http://servizi.comune.fi.it/servizi/servizi-spid>